

Urologji



**Shërbimet urologjike
me metodat më të
avancuara të trajtimit**



Urologjia në Spitalin Amerikan u shërben të rriturve dhe të miturve me metoda diagnostike, terapeutike dhe kirurgjikale në të gjitha njësitë e spitalit në Tiranë. Kirurgjia laparoskopike dhe konservative e kanë bërë Departamentin e Urologjisë në mënyrë të padiskutueshme pararojë jo vetëm në vend, por edhe në rajon. Eliminimi i gurëve në veshka me metodat më moderne, pa patur nevojën e një ndërhyrjeje të mirëfilltë kirurgjikale, u ka shërbyer qindra pacientëve në vitet e fundit. Trajtime të tjera si kirurgjitë e tumoreve, trajtimi i impotencës, kirurgjitë e prostatës etj, janë nga fushat kryesore për të cilat ekipi i Spitalit Amerikan është çdo ditë e më i kërkuar.

Ky departament ndjek zhvillimet e fundit në fushën e urologjisë, bazuar në paraqitjen e koncepteve të reja klinike në lidhje me kujdesin e pacientit të tillë si:

- **Urologjia minimale invazive**
- **Urologjia funksionale**

Sëmundja e gurëve në veshka

Në Departamentin e Urologjisë realizohet trajtimi me metodat më moderne i sëmundjes së gurëve në sistemin urinar. Operacionet e hapura dhe endoskopike litotripsike (*percutaneous*, mbyllur) dhe shërbimet litotripsike ofrohen nga një ekip me përvojë. Departamenti ynë është një nga qendrat kryesore të Shqipërisë në trajtimin me metodat endoskopike të gurit, veçanërisht të sëmundjes së traktit urinar. Përveç trajtimit kirurgjikal, ky departament ofron hulumtimet metabolike dhe terapitë mjekësore për parandalimin e sëmundjeve të gurit.

E.S.W.L (litotripsi)

Kjo metodë ka revolucionarizuar trajtimin e gurëve urinarë. Valët tronditëse janë në gjendje të copëtojnë gurë që në momentin që fokusojnë gurët e fragmentuar të cilët janë nxjerrë jashtë nga trupi përmes traktit urinar. Përafërsisht 85-90% e pacientëve me gurë renal më të vogël se 2.5 cm që trajtohen me ESWL, dalin me sukses.

Komplikacionet e kësaj metode janë:

- Gurët nuk mund të copëzohen
- Copat e fragmentuara mund të grumbullohen dhe të formojnë rërë si materiale apo gurë të reja.
- Mund të zhvillohen infeksionet e traktit urinar

Megjithatë, këto komplikacione janë shumë të rralla. Kjo metodë është më e përdorura dhe terapia më e rehatshme për pacientin.




Nefrolitotomia perkutane

Heqja perkutane **e gurëve renal dhe ureteral** është trajtimi i duhur për gurë më të mëdhenj se 3 cm. Kjo metodë në krahasim me kirurgjinë e hapur të gurit shkakton më pak hemorragji dhe më pak dhimbje. Pas kësaj ndërhyrjeje pacientët kanë avantazhin për t'u kthyer në shtëpi që të nesërmen. Duke ndërhyrë në veshkë në mënyrë endoskopike, ne mund të realizojmë me sukses ndërhyrjen. Si rezultat i përvojës sonë, në qendrën tonë, rreziku i gurëve të mbetur pas ndërhyrjes është minimizuar.

Heqja e gurëve me ureteroskopi

Nxjerrja e gurit me metodën ureteroskopike është një metodë shumë efektive. Ureteroskopi është një instrument optik i përbërë prej metali (45-80 cm gjatësi) që përdoret për të hyrë në traktin urinar në mënyrë retrograde. Pasi kalojmë në uretër nga fshikëza e urinës, nëse gurët janë të vegjël, hiqen me anë të një kateteri të quajtur kateter basket. Nëse guri është i madh thyhet nëpërmjet instrumenteve pneumatike apo ultrasonike.




Trajtimi me kirurgji të hapur

Në rastet kur trajtimet e tjera janë jo efikase si psh: në rastet kur guri është i madh, nëse shkakton infeksione urinare dhe nëse është shkaktare për dëmtimin e veshkave dhe të hemorragjisë, siç mund të jetë ndalimi i rrjedhës së urinës, aplikohet kirurgjia e hapur.

Sëmundje beninje të prostatës

Me avancimin e moshës, tek meshkujt vërehet shpesh hiperplazia beninje e prostatës. Për diagnostikimin e kësaj sëmundjeje mund të kryhen ekzaminime diagnostikuese dhe analiza urinare. Në klinikën tonë aplikohen në mënyrë të suksesshme metodat endoskopike (TUR, operacioni i mbyllur), kirurgji e hapur e prostatës si dhe metodat e trajtimit minimalisht invazive.



Infeksionet urologjike

Në unitetin e sëmundjeve infektive jepen trajtime ambulatore dhe me shtrim për infeksionet urinare.

Uro-Onkologjia

Departamenti ynë është një nga qendrat më të mira të Shqipërisë për sa i përket trajtimit dhe kurimit të kancerit të veshkës, fshikëzës, testit, prostatës dhe penisit. Në këtë departament mund të bëhet diagnostikimi i hershëm i kancerit të prostatës nëpërmjet biopsisë që merret me USG. Në qendrën tonë, pacientëve onkologjikë përveç kirurgjisë endoskopike (të mbyllur) dhe të hapur, i mundësohen kimioterapi, imunoterapi dhe trajtime hormonale. Në trajtimin e kancerit urologjik përpos eksperiencës në vite ofrohen dhe protokollet standarte dhe ato bashkëkohore.



Urologjia pediatrike

Në Spitalin Amerikan, trajtimet kirurgjikale dhe medikale të anomalive kongjenitale të sistemit urinar (reflaksi vezikoureteral, ngushtime ureteropelvike, anomalitë e uretrës, penisit dhe testikujve), infeksionet e shpeshta, fshikëzës neurogjene ofrohen me një koncept bashkëkohor. Pacientët tanë të moshës pediatrike ndiqen nga afër në mënyrë sistematike bazuar në protokollet bashkëkohore të trajtimeve mjekësore.

Urologjia femërore

Në urologjinë e ditëve të sotme bëhet në mënyrë bashkëkohore trajtimi i kistit intersticial, si edhe urinimit në mënyrë të pavetëdijshme (inkontinenca e stresit dhe e shtrëngimit). Bazat e suksesit tonë në urologjinë femërore vijnë nga testet urodinamike që kryhen në departamentin tonë, gjithashtu dhe interpretimi në mënyrën më të mirë të ankesave të pacientit.

Andrologjia

Ofrohen shërbime të trajtimit medical dhe kirurgjikal për defektet e ereksionit dhe infertilitetit tek meshkujt.

Transplanti i veshkave

Duke kryer një punë të koordinuar me Departamentin e Nefrologjisë, ofrohet shërbimi post –operativ në mënyrën më të mirë për pacientët që e kanë kryer transplantin e veshkave në departamentin tonë.

Neuro – Urologjia

Nëpërmjet testeve urodinamike bashkëkohore vendosen diagnozat e sëmundjeve neurogjene të fshikëzës si tek fëmijët ashtu dhe tek të rriturit, ku më pas jepet trajtimi.

Kirurgjia minimalisht invazive

Pothuajse në çdo fushë kirurgjikale urologjike synohet që tek pacienti të mos bëhen prerje të mëdha. Me këtë pikëpamje synohet që të arrihet suksesi i njëjtë si me kirurgjinë e hapur, ku në ditët e sotme është kthyer në procedurë standarte në shumë kirurgji urologjike, që mundëson me pak dhimbje tek pacienti, me pak kohë rehabilitimi, kthim më të shpejtë në jetën normale dhe përmirësim kozmetik. Në klinikën tonë kirurgjia laparoskopike ofrohet gjithashtu dhe si një alternativë e suksesshme dhe efikase për trajtimin e pacientëve me patologjinë e veshkave, prostatës dhe fshikëzës.





Spitali Amerikan

www.spitaliamerikan.com 

Shërbim Urgjence 24h
Shërbime Laboratorike
Kardiologji
Kardiokirurgji
Kirurgji e Përgjithshme
Kirurgji Plastike
Ortopedi
Gastroentereologji
Otorinolaringologji
Obstetrikë - Gjinekologji
Fertilizim In Vitro
Pediatri
Neonatologji
Neurologji
Nefrologji
Urologji

Onkologji
Hematologji
Anatomopatologji
Endokrinologji
Reumatologji
Pneumologji
Alergologji
Dermatologji
Okulistikë
Farmaci
Imazheri e Avancuar
- Rezonancë magnetike
- Skaner 64 dedektorë
- Shintigrafi
- Mamografi
- Densitometri e kockës

SPITALI AMERIKAN TIRANË

042 35 75 35 

LAPRAKË

Rruga "Lord Bajron" pranë SUQU. - Tiranë

RRUGA E DIBRËS

Pranë Fakultetit të Mjekësisë - Tiranë

AMERICAN MEDICAL CENTER DURRËS

052 22 23 33

Lagjja 18. Rruga "Ahmet Ramzoti" - Durrës

SPITALI AMERIKAN PRISHTINË

038 221 661 

Hajvali, Km. 7 - Prishtinë

AMERICAN MEDICAL CENTER FIER

034 23 21 23

Lagjja 1 Maji, Rr. Çamëria - Fier